

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ah, sikur ta kisha shkruar vetë" – Rama ndan reflektimin për manipulimin dhe urrejtjen në hapësirën publike: Nëse politika ka nevojë për gënjeshtër, meriton të mbytet
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/07/ah-sikur-ta-kisha-shkruar-vete-rama-ndan-reflektimin-p er-manipulimin-dhe-urrejtjen-ne-hapesiren-publike-nese-politika-ka-nevoje-per-genjeshter -meriton-te-mbytet/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:46:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 13:40:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ee02f734b0d5b9288ece261a2d644e0d7c8614e7d6138783579065a72d0ca07
TEKSTI	b0d56bb0ec1846c1b9f79dc3e8009356cb9af6b0ec2686a5ec0d5f271baf09c
PAMJA	38bbf04c57325e269bf8903e6854e31b00436e1c1c2e72567776a3a763b50119

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b79da8f49817d7db80e14228116a75fd064d1d20c8eb3f8bf38aa459abd73e39
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

[https://scan.stamles.eu/verify/b79da8f49817d7db80e14228116a75fd064d1d20c8eb3f8bf38aa459a](https://scan.stamles.eu/verify/b79da8f49817d7db80e14228116a75fd064d1d20c8eb3f8bf38aa459abd73e39)
bd73e39

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Ah, sikur ta kisha shkruar vetë” - Rama ndan reflektimin për manipulimin dhe urrejtjen në hapësirën publike: Nëse politika ka nevojë për gënjeshtër, meriton të mbytet

Aktualitet

Publikuar: 07/09/2026



Kryeministri Edi Rama ka publikuar në rrjetet sociale një tekst të gjatë, për të cilin sqaron se nuk është shkruar prej tij, por se është një nga ato shkrime që do të dëshironte t'i kishte shkruar vetë.

Rama e shoqëron postimin me një koment ironik, duke u bërë thirrje ndjekësve ta lexojnë, ndërsa teksti ngre akuza të forta.

Në tekst kritikohet ashpër ajo që përshkruhet si një “industri llumi”, e ngritur mbi shtrembërimin e fakteve, panikun, zemërimin dhe përdorimin e titujve apo videove të manipuluar për të nxitur reagime dhe për të gjeneruar klikime.

RRESHTAT MË POSHTË NUK I KAM SHKRUAR UNË, PO ËSHTË NJË NGA ATO RASTE KUR NJERIU THOTË: AH, SIKUR T’I KISHA SHKRUAR VETË...

Lexojini se do të gjeni shumë fytyra, zëra dhe mashtrime e dyfytësira nga jeta e përditshme para pasqyrave teknologjike

Hapësira publike është kthyer në një sistem kanalesh të ujërave të zeza dhe kutërbimi nuk është nën këmbët tona, por po ngrihet nga foltoret, nga titujt dhe nga goja e njerëzve që e dinë se po jashtënxjerrin plehra, në emër të “guximit”.

Kjo është një industri llumi, e ngritur mbi shtrembërimin, poshtërimin, panikun dhe tërbimin, ku njerëzit bosh kanë mësuar se, nëse arrijnë t'i bëjnë qytetarët të urrejnë, askush nuk do ta vërë re se ata vetë nuk kanë asqë të dobishme për të ofruar.

Me të lexuarat

Rama “djeg” Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Besnik Leskaj...

Besnik Leskaj pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në merrshmi i Beratit / Si...

Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik Rokellipadiga e Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t’ia dhënë biznesmenit...

Enri, ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Enri, ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Nuk u duhen zgjidhje kur mund të prodhohen armiq, as u duhet karakter kur turma është e etur për mizori ndaj shënjestrës njerëzore të radhës.

Ky kanibalizim funksionon sepse shumë njerëz janë përshtatur e rehatuar duke jetuar në vorbullën e tij. Ata e dinë se fragmenti i videos është prerë për të mashtruar, se titulli është fabrikuar si armë, se akuza është fryrë, se zemërimi është inskenuar dhe se njeriu që po tërhiqet zvarritet nëpër baltë është një qenie njerëzore e katandisur në një leckë për klikime dhe reagime. E dinë se faktet po spërdridhen për të nxjerrë një ulërimë therëse dhe fundja e dinë fare mirë, se gënjeshtria është gënjeshtër. Ama u pëlqen, thjesht u shijon tërë spektakli që prodhon gënjeshtria.

Një mospajtim nuk lejohet më të mbetet thjesht një mospajtim. Dikush duhet patjetër të jetë i korruptuar, i paaftë, mashtrues, i kapur ose pjesë e ndonjë konspiracioni të hatashëm. Njerëzit marrin një copëz informacioni, i ngjisin përfundimin që u përshtatet bindjeve të tyre, e hedhin në vorbullën e internetit dhe ja ashtu, si me magji, diçka që nuk ka ndodhur kurrë pranohet si fakt.

Zyrtarët dhe nëpunësit publikë trajtohen në mënyra që do të ishin të papranueshme pothuajse kudo e kurdoherë tjetër, a thua se thjesht zgjedhja për t'i shërbyer publikut nënkupton pranimin e një abuzimi pa kufi. Kjo është ajo që duhet t'i neveritë njerëzit. Jo mospajtimi, por oreksi për të parë dikë të keqtrajtohet dhe prapëseprapë për ta shpërndarë gënjeshtrenë për të. Oreksi për të parë një fqinj të shndërrohet në armik, sepse kjo të kënaq më shumë sesa të pranosh që bota është ca më e ndërlikuar se sa duket. Dhe më e keqja, lejimi i një frikacaku me kamerë, mikrofon, titull në dorë apo platformë në zotërim, që të fusë dorën në krahatorin tonë, t'u drejtohet instinkteve tona më të këqija dhe të na bindë se ato janë parime.

Shumë njerëz nuk kanë më bindje politike, po kanë vetëm një varësi toksike. U duhet zemërimi i radhës, zuzari i radhës, videoja e radhës dhe justifikimi i radhës për t'u ndjerë më të mirë se të tjerët, pa qenë aspak njerëz më të mirë dhe ndaj ia kanë dorëzuar zhurmës krejt ndërgjegjen e tyre!

Shërbimi publik nuk duhej të kthehej kurrë në një material për thertoren e besimit, në një skenë për ego të papëmbushura apo në karburant për një makineri që i shndërron njerëzit në armiq imagjinarë për disa klikime. Një nënë që lufton të mos i fiken dritat nuk ka nevojë për tërbim teatral. Një veteran që pret kujdesin që i takon nuk ka nevojë për një video të manipuluar. Një mësues që blen me paratë e veta mjetet e shkollës nuk ka nevojë për panik të fabrikuar. Njerëzit që po përpëliten nga kostoja e rritur e jetesës nuk kanë nevojë për frikacakë të radhës që ua shesin urrejtjen si aftësi udhëheqëse.

Shërbimi publik nuk duhet të prodhohet armiq, as u duhet karakter kur turma është e etur për mizori ndaj shënjestrës njerëzore të radhës.

Dhe ju lutem, ma kurseni predikimin e kujtesë që noton gjatë javën në kanalizimet e qelbura dhe pastaj shfaqet duke kutërbuar nga ambicia personale. Ma kurseni drejtësinë e rreme të njerëzve që i bëjnë qytetarët më të zemëruar, më pak të ndjeshëm e më pak të ndershëm, po edhe më të manipulueshëm, teksa për vete hiqen sikur po i shërbejnë diçkaje më të madhe se uria e tyre e pangjishme për vëmendje.

Nëse politika e tyre ka nevojë për gënjeshtër që të marrë frymë, ajo meriton të mbytet. Nëse lëvizja e tyre ka nevojë t'i zhveshë njerëzit nga njerëzorja për të mbijetuar, ajo e ka vendin në kanalin e ujërave të zeza. Nëse ndikimi i tyre varet nga helmimi i njerëzve kundër njëri-tjetrit, ata nuk janë udhëheqës po vetëm pjesë qorre të këtij sistemi ujërash të zeza.

Në bisht fare, pyetja që mbetet është kjo: Çfarë je i gatshëm të bëhesh për të mposhtur njerëzit që të kanë thënë se duhet t'i urresh?

Nëse je gati të bëhesh gënjeshtar, frikacak, manipulues apo njeri që kënaqet duke parë njerëz të panjohur të zhvishen nga dinjiteti i tyre njerëzor, atëherë nuk e ke mundur kalbëzimin që thua se po lufton. Thjesht, je bërë pjesë e tij.

Brooks Williams, Administrator i Qytetit Ferris, TEXAS, SHBA

TAG:

hapësira publike

Rama

Reflektim

Të ngjashme

Nafta shtrenjtohet në Shqipëri, fqinjët mbajnë çmimet të pandryshuara! Braçe kërkon shpjegime, ngre pikëpyetje për tregun e karburanteve

Çmimi i naftës tjetër rekord, po shitet me 229 lekë litri / A do të rikthehet Bordi i Transparencës?

Zbardhet raporti i Von der Leyen, vlerëson Shqipërinë për mbylljen e tre kapitujve të parë negociues

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION **DOSJE ROZË**

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe
lidhjet e padukshme mes partive politike,
mediave të njësuar me interesat
klienteliste, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.